



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ .2024

VENDIM

Nr. 357 datë 11.07.2024

PËR

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 97, DATË 29.02.2024 TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR, “PËR PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NR.
1/2024, TË FILLUAR NDAJ MAGJISTRATES, ZNJ. {...}, ME FUNKSION
GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË” DHE VJIMIN E SHQYRTIMIT TË TIJ**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 97 pika 3 dhe 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 66, 67, 68 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 97, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR